



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M Q A R K U L L U E S

Nr.14, datë 30.04.2020

**Për caktimin e shoqërisë “PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.” si  
auditues i brendshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave  
për vitin financiar 2020**

Në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja “j”, të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 7 pika 6, të nenit 18, pika 1 dhe pika 2 të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, Këshilli Drejtues,

**V E N D O S I:**

1. Të caktojë shoqërinë “PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.” si auditues i brendshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2020.
2. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm për nënshkrimin e kontratës me shoqërinë “PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.”.
3. Të caktojë Znj. Nexhmije Çela për ndjekjen e zbatimit të kushteve të kontratës ndërmjet Agjencisë dhe shoqërisë “PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.”.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**